



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I. Numër: 06/01-40965 dt. 29 Qershor 2026

Në bazë të nenit 11, nenit 12 par.2 pika d, nenit 14 par.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 të neneve 5,6,8 dhe 14 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunës, neni 4, neni 5 paragrafi 1.2, neni 6 dhe neni 13 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30. shtator 2020, Vendimit Nr. 08/2026 mbi miratimin e listës së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026, me numër protokolli 400/01-8274 të datës 26 Shkurt 2026, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afat gjatë të parcelës komunale – Zyrrave të katit të III (tretë) tek Poliklinika Stomatologjike për shërbime gastronomike - *Parcela Komunale 1757-0 në sipërfaqe prej 10750m² e cila është e destinuar për shërbime gastronomike*, Kuvendi i Komunës Pejë, në takimin e mbajtur me datë 29 Qershor 2026, merr këtë:

VENDIM

Nr. 75/2026

Mbi miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale – përkatësisht zyrrave të katit të III (tretë) tek Poliklinika Stomatologjike për ofrimin e shërbimeve gastronomike.

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të sipërfaqes prej 10750m² e identifikuar me certifikatën e pronës me numër 1757-0 pronë Komuna Pejë cila është e destinuar për qiradhënie në afat prej tridhjetë e pesë (35) vite, sipas Vendimit Nr.08/2026 mbi miratimin e listës së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026, me numër protokolli 400/01-8274. dt. 26 Shkurt 2026.

Nr.	PRONARI Poseduesi	Nr. i Ngastrës	Emri i rrugës (lokacioni)	Sipërfaqja	Zona Kadastrale	Destinimi	Periudha
1.	Komuna Pejë	1757-0	Rr. “Nëna Terezë” Zyrat e katit të III (tretë) tek Poliklinika Stomatologjike	10750m ²	ZK Pejë	Për ofrimin e shërbimeve gastronomike	35 vite

- II. Dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës së paluajtshme të komunës më shumë se pesëmbëdhjetë (15) vite deri në nëntëdhjetë e nëntë (99) vite bëhet përmes shprehjes së interesit.

- III. Pas plotësimit të kushteve ligjore komisioni për komunal për vlerësimin e ofertave do të inicioj procedurën përmes shprehjes së interesit, për zgjedhjen e ofertës më të favorshme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të zyrave të katit të III (tretë) tek Poliklinika Stomatologjike – parcela nr. 1757-0, pronë komunale në ZK Pejë në sipërfaqe prej 10750m², e cila është e destinuar për qiradhënie në afat prej tridhjetë e pesë (35) vite.
- IV. Për zbatimin e këtij Vendimi dhe dispozitave të ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, obligohet që të kujdeset Komisioni Vlerësues, Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike.
- V. Ky vendim hynë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në web- faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:
MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.

